



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/ *373*

Datë: 01.10.2018

PROCESVERBAL

I mbledhjes së I (parë) urgjente e Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2019-2021

Mbledhja mbahet me datë: 28.09.2018, dhe filloi në ora 09:00. Morën pjesë Kryesuesi i Komitetit, 3 anëtarë të Komiteti, pa praninë e Zyrës për Informim dhe OSBE-së

Rrahim Morina: Faleminderit për pjesëmarrje. Sot kemi vetëm një pikë të rendit të ditës e cila është “ Shqyrtimi dhe Miratimi i projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2019-2021, ndërkohë na ka arritur projekt-buxheti i propozuar nga anëtarët e grupeve të Kuvendit të PDK-së, LDK-së dhe LVV-së. Ne projekt- buxhetin për vitin 2019-2021 i cili ka ardhë nga ekzekutivi e kemi shqyrtuar në leximin e parë dhe sot për debat e kemi leximin e dytë. Qeveria Komonale nuk i ka sjell kërkesat e këshilltarëve pas leximit të parë edhe përkundër asaj që unë e kam kërkuara nga Drejtori për Ekonomi dhe Financa, mirëpo ai është deklaruar se këto ndryshime i sjell në Kuvend, ditën e Premte. Ndërsa sot ka arritur “Projekt-buxheti për vitin 2019-2021 i propozuar nga anëtarët e grupeve të Kuvendit të PDK-së, LDK-së dhe LVV-së”, të cilin duhet ta debatojmë për ta futur në rendin e ditës në këtë mbledhje. Unë kam qenë në konsultim me Kryetarin e Komunës, për ta përpiluar rendin e ditës dhe pasi që Kryetari ka kuptuar se ka propozime të tjera për projekt-buxhetin e Komunës së Malishevës, na ka penguar në zhvillimin e procedurave dhe ka urdhëruar zyrtarët komunal dhe drejtorët, që mos të marrin

pjesë në mbledhjen e KPF-së, gjithëashtu vlenë të theksohet që Kryetari ka penguar edhe publikimin e ftesës për mbledhje urgjente të KPF-së dhe të Kuvendit në faqën zyrtare të Komunës, si dhe shpërndarjen e materialit të mbledhjes së KPF-së dhe Kuvendit. Hap debat rreth rendit të ditës?

Hashim Vrenezi: Përshëndetje! Unë pajtohem që të futet në rend të ditës propozimi i projekt-buxheti nga anëtarët e PDK-së, LDK-së dhe LVV-së.

Valon Krasniqi: Edhe unë pajtohem me propozimin e Hashimit.

Raimonda Krasniqi: Ky projekt-buxhet i propozuar nga anëtarët e grupeve të Kuvendit PDK, LDK, LVV, duhet të futet gjithsesi në rend dite.

Rrahim Morina: Kush është për ta futur në rend dite projekt-buxhetin e propozuar nga anëtarët e grupeve të Kuvendit të PDK-së, LDK-së, LVV-së?

Për: 4 unanimitet

Faleminderit, në rend të ditës futet edhe pika e propozuar nga grupet e anëtarëve të Kuvendit të PDK-së, LDK-së, LVV-së, dhe në fund kush është për këtë rend dite?

Për: 4 unanimitet

Hap debat rreth rendit të ditës?

Hashim Vrenezi: Në këtë projekt-buxhet kemi bashkëpunuar si parti opozitare për të sjell projekte konkrete për qytetarët. Ne e kemi ruajtur strukturën e projekt-buxhetit Begaj, por ne kemi hartuar një projekt-buxhet që përfshinë prioritetet dhe kërkesat e qytetarëve të cilat janë të shumta. Nuk jemi kundër projekt-buxhetit të Kryetarit Begaj, por kemi dashur të jetë një buxhet për të gjithë qytetarët. Ne mendojmë që për Kuvend të rekomandohen dy projekt-buxhete:

a) Projekt-buxheti i propozuar nga Kryetari i Komunës, z. Ragip Begaj.

b) Projekt-buxheti i propozuar nga anëtarët e Kuvendit të grupeve të PDK-së, LDK-së, LVV-së.

Valon Krasniqi: Po dihet që seancën e ardhshme kemi dy projekt-buxhete, një nga ekzekutivi dhe një nga asambleistat e Kuvendit Komunal. Unë mendoj që projekt-buxheti i përpiluar nga

partitë opozitare është më gjithëpërfshirës dhe ne e rekomandojmë për Kuvend Komunal, si dhe mendoj të jemi më unik dhe të përkrahim kërkesat e qytetarëve.

Rrahim Morina: A po pajtoheni që këto dy projekt- buxhete të rekomandohen për Kuvend Komunal?

Për:4 unanimitë

Mbledhja përfundoi në ora 10:00.

Procesmbajtësja:

Verëllinda Gashi



Kryesuesi i Komitetit

Rrahim Morina

